



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 173/1 prot.,

Tiranë, më 20/01/2026

Lënda: Njoftim mbi rezultatet e vlerësimit të testimit me shkrim të kandidatëve që konkurronin sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor”.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 18, 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, më datë 20.01.2026, ora 11.00 në ambjentet e Gjykatës së Lartë u zhvillua testimi me shkrim i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, që konkurrojnë për pozicionet vakante të shpallura në Gjykatën e Lartë me shpalljet e datës 17.12.2025, sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor”.

Në përfundim të testimit Komisionet e Pranimit vijuan me vlerësimin e kandidaturave të kualifikuara sipas pozicioneve përkatëse dhe konkretisht:

Për vendin vakant:

- **“specialist i marrëdhënieve me jashtë”**, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, kategoria ekzekutive, IV-1,

znj.Mirela Muka u vlerësua me **48.33 pikë**

Për vendin vakant:

- **“specialist i marrëdhënieve me publikun”**, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, kategoria ekzekutive IV-1,

Znj. Nergisa Rakipi u vlerësua me **51.33 pikë**

dhe

Znj. Fjoralba Cale u vlerësua me **42.66 pikë**

Për vakancën

- **“specialist”** - Qendra e Dokumentacionit, kategoria ekzekutive, IV- I,

Znj. Andia Haxhi u vlerësua me **47 pikë**

Për vakancën

- **“sekretare gjyqësore”** - Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria ekzekutive, IV- I,

Znj. Kiara Laze u vlerësua me **50.33 pikë**

Për sa më sipër kandidatët janë vlerësuar me mbi 70% të pikëve të testimit me shkrim (me mbi 42 pikë) dhe kualifikohen, të gjithë sipas pozicioneve përkatëse, për fazën pasardhëse të konkurrimit të hapur, atë të intervistës së strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.

Për **datën** dhe **orën** e intervistës së strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike.

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO

